

DEKLARATA E SHKUPIT

Marrëveshja për ndryshimet klimatike për periudhën pas vitit 2020

DRAFT I PARË

Ne, Ministrat/Shefat e delegacioneve të vendeve anëtare të Iniciativës së Evropës Qendrore (IEQ), përgjegjës për çështjet që kanë të bëjnë me ndryshimet klimatike, u mbledhëm në Shkup, Republika e Maqedonisë, më 6 nëntor 2015, **në Konferencën Ministrore për Ndryshimet Klimatike,**

Jemi të vendosur që t'i përkushtohemi ndryshimeve klimatike për të cilat nevojitet një bashkëpunim dhe aksion urgjent në nivel global, rajonal dhe kombëtarë,

Të shqetësuar nga fakti se vendet anëtare të IEQ tani më i përjetojnë efektet negative të ndryshimeve klimatike, të cilat i kërcënojnë përpjektet e tyre për realizimin e zhvillimit të qëndrueshëm, ç'rrenjosjen e varfërisë dhe sigurimin e ushqimit,

Duke i vërtetuar përpjekjet rrjedhëse për aksionin e klimës në nivel global si dhe në rajonin e IEQ-së ,

Duke e njohur rëndësinë e sigurimit të mbështetjes financiare, teknike, teknologjike dhe mbështetjes për ndërtimin e kapaciteteve, për vendet nga IEQ-ja, t'i zbatojmë politikat dhe aksionet për ndryshimet klimatike.

Duke vlerësuar punën që u përfundua gjatë Sesionit ad-hok të grupit punues për platformën e Durbanit për aksionin e përsheptuar, që u mbajt nga 8 deri më 13 shkurt 2015 në Gjenevë, duke arritur një tekst të harmonizuar për negociatën, i cili do ta paraqesë bazën për negociatat e protokollit, instrument juridik ose dokument tjetër me fuqi ligjore për të cilin do të arrihet pëlqimi, me qëllim që të miratohet në sesionin e 21 të Konferencës së Palëve (COP 21),

1. **Më tej theksojmë** se, sipas konventës së KB për ndryshimet klimatike, marrëveshja e re, protokollit, një instrument juridik ose dokument tjetër me fuqi të ligjit për të cilin do të arrihet pajtueshmëria, me qëllim që të miratohet në COP 21, duhet ti përmbajë parimet e barazisë, përgjegjësitë e përbashkëta por të diferencuara dhe aftësitë përkatëse , si dhe për sigurimin e mjeteve financiare, zhvillimin dhe transferimin e teknologjisë dhe ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha vendet me qëllim që të mbështeten aktivitetet e tyre për zbutjen e ndryshimeve klimatike dhe përshtatjen ndaj tyre,
2. **Vendosëm** që të kontribuojmë drejt suksesit të negociatave për ndryshimet klimatike gjatë gjithë vitit 2015 ,
3. **Vendosëm** që ti prezentojmë disa kontribute kombëtare të planifikuara, në bazë të parimit të përbashkët por të diferencuar, si dhe kushtet e posaçme kombëtare,

4. **Vërtetohet** se do të përpiqemi që të arrijmë një marrëveshje gjithpërfshirëse, ligjërisht të detyrueshme, të drejtë, fleksibile, afatgjatë, për klimën pas vitit - 2020, të COP 21,
5. **E theksojmë** rëndësinë se marrëveshja e re, protokolle ,një instrument juridik ose dokument tjetër me fuqi të ligjit për të cilin do të arrihet pajtueshmëria duhet të paraqesë një lehtësim për kalimin drejt strategjive për një zhvillim me nivel të ulët të emisioneve ,
6. **Kërkojmë** që Sekretariati i IEQ ta shqyrtojë mundësinë e bashkëpunimit me Sekretariatit e Konventës së KB për ndryshimet klimatike, për hartimin e një strategjie rajonale të IEQ për betejën me ndryshimet klimatike, përfshirë këtu edhe mjetet për mbështetje shtesë teknike dhe financiare për hartimin dhe implementimin e programeve, projekteve dhe aksioneve që kanë të bëjnë me klimën,
7. **E shprehim** falënderimin tonë të thellë për Qeverinë dhe Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor të Republikës së Maqedonisë për organizimin e shkëlqyeshëm të Konferencës dhe mikpritjen e ngrohtë ndaj delegacioneve pjesëmarrëse.

Shkup, më 6 nëntor 2015